

Biografi



Ermal Pacaj ka lindur më 10 janar 1986 në Lezhë. Arsimin e mesëm e kreu në gjimnazin e përgjithshëm "Hydajet Lezha" në Lezhë. Më pas, vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Tiranës, ku u diplomua në degën e Psikologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale në qershor të vitit 2008.

Pas përfundimit të studimeve, Ermal Pacaj ka shërbyer për gjashtë vite në sektorin privat si Administrator. Ai ka një përvojë të gjerë në administratën publike, ku ka punuar për një periudhë prej 11 vitesh në nivele të ndryshme, si në administratën vendore ashtu edhe në atë qendrore.

Në nivel drejtues, Ermal Pacaj ka kryer me sukses detyra të rëndësishme si Drejtor Rajonal për qarkun e Lezhës në Sigurimet e Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor (FSDKSH) nga janari 2014 deri në nëntor 2017. Më pas, ka shërbyer si Administrator i Sh.A Porti Detar Shëngjin gjatë periudhës nëntor 2017 – nëntor 2019. Ai gjithashtu, ka qenë Zëvendëskryetar i Bashkisë Lezhë nga nëntori 2019 deri në mars 2024.

Më 13 mars 2024, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 153, Ermal Pacaj është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.